



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b, dhe të nenit 40 të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2006, merr

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E QENDRËS KULTURORE REKREATIVE NË GËRMI

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kulturore - Rekreative në Gërmi.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 214/1, komuna kadastrale-Sofali, fleta poseduese nr. 151, në sipërfaqe prej 1ha, 97 arë, 97 m² dhe pjesa e ngastrës kadastrale nr. 234 komuna kadastrale-Sofali, fleta poseduese 151, në sipërfaqe prej 0 ha, 02 arë. 02 m², e evidencuar si pronë shoqërore- Kuvendit Komunal Prishtinë.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm zhvillimor të komunës së Prishtinës dhe në planin rregullues për këtë zonë.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objekteve investive për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 351-315, më 30.06.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri